STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE KATER QARQE TE TJERA TE PREKURA NGA URAGANI SENDI (SANDY) KANE TE DREJTEN E NDIHMES SE ASISTENCES FEDERALE INDIVIDUALE

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se katër qarqe të tjera janë shtuar në deklaratën federale të katastrofës së madhe për Uraganin Sendi (Sandy). Deklarata federale e katastrofës së madhe tani ofron Ndihmë Individuale për banorët e qarqeve të Oranxhit (Orange), Putnëmit (Putnam), Sallivënit (Sullivan) dhe Ulstërit (Ulster).

"Falënderoj Presidentin Obama për shtimin e këtyre katër qarqeve në deklaratën e katastrofës së madhe," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Pasojat shkatërruese të Uraganit Sendi (Sandy) kanë një ndikim të madh dhe do të kërkojnë shumën maksimale të ndihmës federale, në mënyrë që këto komunitete të mund të rindërtohen dhe të rimëkëmben."

Më 30 tetor, Presidenti Obama pranoi kërkesën e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) për një deklaratë federale të katastrofës për shtatë qarqe: Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Riçmond (Richmond), Kuins (Queens) dhe Safolk (Suffolk). Më 2 nëntor, Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi se dy qarqe të tjera, Roklënd (Rockland) dhe Uestçester (Westchester) ishin miratuar që të merrnin ndihmë federale të katastrofës si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy).

Qarqet që kanë të drejtë për Ndihmën Individuale dhe Publike: Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Kuins (Queens) dhe Safolk (Suffolk), Uestçester (Westchester)

Qarqet që kanë të drejtë vetëm për ndihmë individuale: Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulstër (Ulster)

Deklarata federale e katastrofës u miratua për të lejuar që qeveria federale të sigurojë ndihmë dhe burime për Shtetin e Nju Jorkut dhe pushtetin vendor për të mbështetur veprimtaritë që kanë lidhje me evakuimin, strehimin dhe masat e tjera mbrojtëse, përfshirë heqjen e mbeturinave, administrimin e logjistikës dhe krijimin e energjisë elektrike.

Të mbijetuarit e katastrofës kanë tre mënyra për të bërë kërkesa:

- Individët mund të telefonojnë në 1-800-621-FEMA (3362) ose TTY 1-800-462-7585 për personat me vështirësi të të folurit dhe të dëgjimit.

- Nëse përdorni Shërbimet e 711-Rele (711-Relay) ose Rele me Video (Video Relay) Services (VRS), telefonojini 1-800-621-3362.
- Mund të rregjistroheni në internet në www.disasterassistance.gov ose nëpërmjet telefonit ose tabletës që lejon përdorimin e internetit ose në m.fema.gov.

Numrat telefonikë falas do të funksionojnë nga 7 në mëngjes deri në 10 pasdite EDT, shtatë ditë në javë deri në një njoftim të ardhshëm.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418